



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Priljena/Prodato Received/Delivery	19-02-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM84HX	763/2022		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 24/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave nga: Malsore Gashi Bajraktari-Kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca anëtarë, si dhe Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.1911/2020, të datës 14.01.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 239/2020 të datës 21.08.2020 të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimit Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, në çështjen juridike "Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 14.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.239/2020, i datës 21.08.2020 e parashtruar nga ankuesja
- II. **ANULOHET** Vendimi me numër protokoli 2020 ADM 1185 i datës 22.07.2020, i Drejtores së Departamentit për Administratë dhe Burime Njerëzore për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje".
- III. **OBLIGOHET** Zyra për Burime Njerëzore e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, që të largoj nga dosja personale e nëpunëses civil masën disiplinore "Vërejtje" nga pika 2 e këtij vendimi.
- IV. **OBLIGOHET** Autoritetit i Aviacionit Civil të Kosovës që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditsh nga data e pranimit të këtij vendimi, të njoftoi me shkrim Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për ndërmarrjen e veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 19.07.2019 në pozitën "Udhëheqëse e



Njesisë së Burimeve Njerëzore” me datë 21.08.2020, ka parashtruar ankesë nëpërmjet e-mailit me numër protokoll 1596/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoll 2020 ADM 1185 të datës 22.07.2020, të Drejtores së Departamentit për Administratë dhe Burime Njerëzore për shqiptimin e masës disiplinore “Vërejtje”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 03.09.2020 ka dorëzuar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës. Këshilli me datë 16.09.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.10.2020 përmes Njoftimit me numër protokoll 1973/2020, ka njoftuar ankuesen se nuk mund të vendos lidhur me ankesën A.Nr.239/2020 të datës 21.08.2020, për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke e udhëzuar të njëjtin mbi të drejtën e inicimit të procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 14.01.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1911/2020, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke anuluar njoftimin e datës 05.10.2020 të KPSHMCK-se dhe ka obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën me numër A.nr.239/2020 të datës 21.08.2020 të parashtruar nga ankuesja.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.239/2020 e datës 21.08.2020, me numër protokoll 1596/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimi me numër A.nr.1911/2020, i datës 14.01.2022, i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 03.09.2020; Njoftim i datës 05.10.2020; Vërejtja e datës 22.07.2020, nga Drejtori i Departamentit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore; E-mail nga S.S. për S.S. i datës 23.07.2020; E-mail nga S.S. për XH.L. i datës 23.07.2020; E-mail nga H.M. për S.S. i datës 23.07.2020; Kërkesa për pushim e S.S. e datës 30.07.2020; E-mail nga H.M. për S.S. i datës 06.08.2020; E-mail nga H.M. për L.P. i datës 23.07.2020; E-mail nga L.P. për H.M. i datës 23.07.2020; E-mail nga H.M. për L.P. i datës 23.07.2020; E-mail nga L.P. për S.S. i datës 23.07.2020; E-mail nga H.M. për S.S. i datës 21.07.2020; E-mail nga H.M. për B.E. i datës 09.07.2020; E-mail nga S.S. për B.E. i datës 08.07.2020; E-mail nga S.S. për B.E. i datës 07.07.2020; E-mail nga S.S. për XH.L. i datës 17.07.2020; E-mail nga S.S. për B.E. i datës 03.07.2020; Vendim me nr. reference 20/2019 i datës 17.07.2019; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit i datës 19.07.2019; Përshkrimi i Detyrave të Punës i datës 19.07.2019; E-mail nga S.S. për CAA.STAFF i datës 20.07.2020; Njoftim me nr. 569 i datës 17.07.2020; Aktvendim AA.nr.957/2019 i datës 17.06.2020; Përgjigje në ankesë e datës 16.09.2020; E-mail nga Ankesa KPMSHCK për S.S. 21.08.2020; E-mail nga S.S. për Ankesa KPMSHCK i datës 20.08.2020; Përgjigje e datës 15.09.2020;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore si dhe pas analizimit të të gjitha provave të lëndës, konstatoi që ankesa e ankueses, është e bazuar, sepse:

Nga shkresat e lëndës rezulton së ankuesja Safete Selmani është e punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës



19.07.2019 në pozitën "Udhëheqëse e Njesisë së Burimeve Njerëzore", ndërsa sipas përshkrimit të detyrave të vendit të punës për pozitën "Udhëheqëse e Njesisë së Burimeve Njerëzore" ankuesja i raporton drejtpërdrejtë Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

Me datë 21.08.2020 Drejtorja e Departamentit për Administratë dhe Burime Njerëzore ka shqiptuar ndaj ankueses masën disiplinore "Vërejtje", për shkak të shkeljes së detyrave të punës nga neni 46 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik.

Ankuesja brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se Vendimi i kundërshtuar më ankesë, është i pa bazuar për shkak cenimit të dispozitave të procedurës disiplinore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke shtuar me tej se „Vërejtja“ i është dhënë nga organi jo kompetent, sepse e njëjta i përgjigjet drejtpërdrejtë Drejtorit të Përgjithshëm .

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht kapitullin IV, lidhur me Disiplinën në Shërbim Civilë, si dhe Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, me të cilën është rregulluar procedura dhe masat disiplinore për nëpunësit civil. Ndërsa në kuptim të kompetencës për zhvillimin e procedurës disiplinore dhe shqyrtimin e masave disiplinore, Kolegji ju referua nenit 48 paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me të cilin është përcaktuar se: "Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë", e mbi këtë bazë ligjore rrjedh se Drejtorja e Departamentit për Administratë dhe Burime Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës nuk ka pasur kompetencë për të shqiptuar ndaj ankueses masën disiplinore "Vërejtje", sepse në bazë të dëshmimeve të ofruara nga ankuesja dhe organi i punësimit konkretisht në bazë të Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 19.07.2019 të ankueses dhe Përshkrimit të detyrave të vendit të punës për pozitën "Udhëheqëse e Njesisë së Burimeve Njerëzore" të datës 19.07.2019, ankuesja i raporton drejtpërdrejtë Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, andaj Kolegji konstaton se Drejtorja e Departamentit për Administratë dhe Burime Njerëzore nuk është mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë e saj.

Meqenëse një akt administrativ i nxjerrë nga organi i cili nuk ka pasur kompetencë konsiderohet akt i paligjshëm sipas nenit 52 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se shqyrtimi i pretendimeve tjera ankimore në rastin konkret është jo relevant.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nënin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagesë mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr. 24/2022

Çlirim Zeka


Procesmbajtës

Malsore GASHI/BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, Gjyqtarit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës ;
- Arkivit të KPMSHCK-së,

